

[\[Printo\]](#)[\[Google Translate\]](#)

LIGJ

Nr. 9/2013

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 304, DATË 15.7.2010 "PËR SEKTORIN MINERAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË"

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 304, datë 15.7.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 2, pika 35 ndryshohet si më poshtë:

"35. "Strukturë përgjegjëse" është institucioni shtetëror, i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave, për të siguruar zbatimin e këtij ligji. Për qëllime dhe në funksion të veprimtarisë inspektuese, strukturë përgjegjëse do të nënkuptojë Inspektoratin Shtetëror përkatës, të caktuar në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

Neni 2

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7968, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

Copyright 2013 - www.ligjet.org